



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:024707

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05529170

KF.nr.606/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Raiffeisen Bank Kosovo JSC” me seli në Prishtinë, rr. “UÇK” nr.51, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me paditën e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë e kontestit 991,605.00 euro, në seancën e shqyrtimin kryesor-publik të mbajtur me 21.03.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Fatlum Shala dhe përfaqësueses së palës së paditur L.Xh., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Raiffeisen Bank Kosovo JSC” me seli në Prishtinë.
- II. Anulohet vendimi nr.446/2014 i datës 18.12.2014 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “Raiffeisen Bank Kosovo JSC” me seli në Prishtinë, tia kthej shumën prej 937,077.51 euro (nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë e një cent), të paguar nga paditësi, si rezultat i mosnjohjes së shpenzimeve të këmbimeve ndërvlutore ,si shpenzime të zbritshme në pasqyrën e të ardhurave për vitin 2008, për Tatim në të Ardhura të Korporatave, me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga

paditësi dhe datën kur e paditura e referon për pagesë-rimbursim Ministrisë së Financave, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

- IV. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit “Raiffeisen Bank Kosovo JSC” me seli në Prishtinë përtej shumës së gjykuar në diapozitivin III të këtij aktgjykimi, për kthim edhe të shumës në vlerë prej 54,528.09 euro (pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e tetë euro e nëntë cent), si rezultat i mos njohjes së shpenzimeve të këmbimeve ndërvalutore, si shpenzime të zbritshme në pasqyrë e të ardhurave për vitin 2008, për Tatim në të Ardhura të Korporatave.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e datës 16.01.2015, ka iniciuar këtë konflikt tregtar administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore të Kosovës, duke kërkuar anulimin e vendimit të Departamentit të Ankesave, nr. 446/2014, i datës 18.12.2014. për shkak të mos aplikimit të drejtë të dispozitave ligjore si dhe për shkak se në procedurë nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe këmbimi ndërvalutor në vlerë prej 4,958,028,00 euro ti njihet paditësit si shpenzim i zbritshëm për TAK për vitin 2008, të anulohet raporti i kontrollit i datës 06.08.2014 si dhe të obligohet e paditura që ti kompensoj paditësit dëmin e shkaktuar në shumë prej 99,605.00 euro me kamatë ligjore duke filluar nga data 21.06.2010 kur paditësi ka paraqitur ankesë në Departamentin e Ankesave në ATK. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka shtuar se e paditura palës paditëse nuk i ka njohur si tatim të zbritshëm apo shpenzim për vitin 2008 shpenzim i cili kishte rezultuar nga humbja e kontratave të këmbimeve valutore të njohura si SWAP pa bazë ligjore edhe pse në të kaluarën pala paditëse për gjatë vitit 2006 dhe 2007 kur paditësja kishte pasur fitim nga ky instrument bankar e kishte detyruar të njëjtën që të paguaj tatim në fitim, ndërsa në rastin konkret kur pala paditëse kishte pësuar humbje në vlerë rreth 5 milion euro e njëjta duke përdorur standard të dyfishtë mbi bazën ligjore të njëjtë nuk i kishte zbritur shumën prej 991,000.00 euro sepse nuk e kishte njohur si shpenzim. Më tej ka shtuar se sa i përket aktvendimit të Dhomës të Shkallës së Dytë konsiderojnë se rekomandimet e të njëjtit janë abstrakte duke mos specifikuar saktë që gjykata në shkallë të parë të njëjtat ti eliminojë dhe për më tepër po kjo gjykatë citon se ‘’ Ku e paditura ka mohuar të jep përgjigje kontrollit sa i përket ndodhjes së

shpenzimeve në degën amë në Austri si dhe të vërtetohen prova që ka paguar paditësi në drejtim të dokumentimit të shpenzimeve të transaksioneve SWAP të realizuara në raport me degën e saj “Raiffeisen Central Bank”. Tutje njoftoi gjykatën duke theksuar se siç është njoftuar edhe më herët se Raiffeisen Bank në Kosovë është entitet i veçantë e regjistruar si Shoqëri aksionare dhe nuk ka as degë amë e as nuk është degë e askujt, për më tepër si provë gjykatës i ofroi certifikatën e regjistrimit për paditësen. Ndërsa sa i përket vërtetimit të provave thekson se konsiderojmë se të njëjtat janë provuar dy herë nga kjo gjykatë në shkallë të parë, nuk janë kontestuar asnjë herë, ekziston ekspertizë financiare dhe dy plotësime të ekspertizës të pa kontestuara nga palët dhe për më tepër e njoftojmë këtë gjykatë me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë ku për çështje identike dhe në mes të palëve identike por për shpenzime të vitit 2009 e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë, të cilën e dorëzojmë si provë në këtë seancë. Lidhur me arsetimin e të paditurës se pala paditëse vet e ka deklaruar tatimin deklaracion se është arsyetim totalisht i pa bazuar për faktin se dispozitat e ligjit e lejojnë korrigjimin e deklaracionit brenda një periudhe të caktuar kohore i cili korrigjim është bërë pas përgjigjes të cilën e kemi pranuar nga ATK-ja ku të njëjtit deklarojnë se shpenzimet e këmbimeve ndër valutore i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të tatimit në të ardhurave të korporatave e që i bie nëse nga këto transaksione ka fitim duhet të paguhet tatim, nëse ka humbje duhet të jetë shpenzim i zbritshëm. Sa i përket justifikimit të ATK se BQK në shkresën e saj të cilën i referohen të njëjtit se Banka Raiffeisen nuk ka përdorur strategji nuk ka asnjë lidhje shkak pasojë në pagesën e tatimeve. Për më tepër është vet raporti i ekzaminimit të BQK të Kosovës i datës 29.04.2009 ku në faqen 13 të tij e sqaron dhe e legjitimon veprimtarinë e këmbimeve ndër valutore sepse është instrument i ligjshëm dhe i përdorshëm dhe i si i tillë duhet të njihet në deklaracionin tatimore qoftë si fitim apo si shpenzim. Në lidhje me mos ofrimin e dokumenteve të kërkuara nga ATK është një justifikim abstrakt i tyre sepse i tërë dokumentacioni konform ligjeve të aplikueshme nga ATK i është ofruar të njëjtës dhe për më tepër një gjë e tillë vërtetohet fare lehtë nga deklarimet të vet zyrtarit të ATK Demë Korça në cilësi të dëshmitarit pranë kësaj gjykate. Sa i përket kërkesës në lidhje me dokumentacionin siç e citoi më herët përfaqësuesi i të paditurës se nga kush janë blerë si janë shpërndarë në Raiffeisen Central Bank i sqarojmë gjykatës se në shkresa të lëndës janë dokumentet e pagesave bankare të realizuara sipas 83 kontratave SWAP, janë konfirmimet e vlerës së tregut si dhe rënia e vlerës së tregut për këto 83 kontrata dhe janë të argumentuara si pranë kësaj gjykate ashtu siç kishin qenë pranë ATK në harmoni të plotë me ligjet e aplikueshme nga ATK se këto shpenzime kanë ndodhur në kuadër të aktivitetit afarist. Gjykatës i

ka propozuar të anulojë vendimin e ATK-së nr. 446/2014 i datës 18.12.2014 dhe të detyrojë të njëjtën që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 937,077.51 euro me kamatë vjetore.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 11.10.2016 ka deklaruar se e konteston ne tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në ligj, për faktin se, te gjitha provat e paraqitura nga pala paditëse, e paditura i ka marr në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe ne mbështetje te nenit 136/a te Ligjit për nr.03/L-28 për Procedurën Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr. 03/L -222 dhe Njoftim Rivlerësimet për Tatimi Shtesë, e paditura ka shqyrtuar ankesën dhe ka vendosur sipas dispozitave të theksuara më lartë. Gjatë seancës dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe të gjitha deklaramive dhe kundërshtimeve të cilat i kanë bërë në këtë objekt kontesti. Më tej ka shtuar se arsyeja e mos pranimi nga kontrolla e këtyre shpenzimeve të këmbimeve valutore ka qenë se fillimisht paditësi në deklaratën vjetore TAK 2008 i ka deklaruar si të pazbritshme shpenzimet e këmbimeve ndër valutore të quajtura si SWAP kontrata, ndërsa pastaj me datën 17.08.2009 paditësi ka bërë korrigjime në këtë deklaratë vjetore dhe pasi janë bërë ndryshime në këtë deklaratë vjetore dhe pasi kontrolla ka marrë përgjigje nga BQK të datës 30.06.2014 ku thuhet se Raiffeisen Bank nuk ka përgatitur strategji për të hyrë në marrëveshje kontraktuale me instrumentet financiare SWAP kontrata dhe nuk ka përcaktuar politikat e saj me angazhimin dhe limitet përkatëse për hyrje në marrëveshje të tilla të instrumenteve financiare SWAP, dhe po ashtu kontrolla ka kërkuar nga paditësja qoftë përmes formës zyrtare AU 003 si dhe përmes email zyrtar që të ofrojë dëshmi lidhur me kontrata SWAP por një përgjigje të tillë kontrolla e ATK –s nuk e ka marrë asnjëherë. Arsyeja e këtyre informatave ka qenë se këto shpenzime a kanë ndodhur nga ana e qendrës së Raiffeisen dhe a janë shpërnda në rajonet e saj, sepse paditësi është person i lidhur me qendrën në Austri. Ndërsa sa i përket dëshmisë të cilën sot në këtë proces gjyqësor përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse e dorëzon, certifikatën e regjistrimit, nuk është relevante aspak për faktin se çdo veprimtari e cila operon ose vepron brenda territorit të Kosovës pavarësisht duhet të regjistrohet, duhet të ketë certifikatën e regjistrimit dhe informatat e kërkuara. Siç e parasheh neni 19 par 6 i Ligjit për ATK dhe procedurat, që barra e provës bie mbi paditësin, nuk është ofruar asnjëherë asnjë përgjigje nga paditësi dhe në mungesë të përgjigje dhe njëkohësisht duke pasur një përgjigje nga BQK që paditësi nuk ka pasur strategji për të hyrë në marrëveshje e kontraktuale për instrument financiare SWAP për kontrollën ka qenë e pamundur të veprohet ndryshe dhe është

vepruar konform provave dhe konstatimit të gjendjes faktike dhe në zbatim të ligjit në fuqi. Sa i përket deklarimit të përfaqësuesit të paditësit lidhur me raportin e BQK për ligjshmërinë e instrumenteve financiare një gjë e tillë nuk ka qenë kontestuese, por në raportin e BQK-së thuhet se paditësi nuk ka bërë strategji për hyrje të këtyre marrëveshjeve për instrumente financiare SWAP kontratat, po ashtu nuk është kontestuar pagesa e 83 kontratave. Por kontestuese kanë qenë shpenzimet për të cilat paditësja nuk ka ofruar asnjëherë përgjigje për ATK-në qoftë përmes email zyrtar apo në formë të shkruar sepse as vet paditësi deri më tani nuk ka arritur të dokumentoj të kundërtën e vlerësimit të ATK për këto shpenzime. Në fjalën përfundimtare i ka kërkuar gjykatës që duke pasur rekomandimet e dhëna nga shkalla e dytë pas shqyrtimit të provave dhe zbatimit të ligjit në fuqi refuzojë padinë e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin nr. 446/2014 të datës 18.12.2014.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në ri-gjykim në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 21.03.2024, ka administruar provat si në vijim: Vendimi 446/2014 i datës 18.12.2014, Raporti mujor në BQK i datës 24.09.2010, Dokumenti lidhur me transaksione SWAP për vitin 2008, Lista e kontratave SWAP për këmbim ndër valutor, Dokumenti i datës 05.12.2013, Kontrata SWAP me shtojcë, Të dhënat nga platformat online Blumberg , Dokumenti i datës 03.04.2009, Raport i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për paditësin për vitin 2008, Raport i kontrollit 18.06.2010, Raporti kontrollit i datës 06.08.2014, Aktvendimi 186/2010 datës 18.09.2010, Kërkesa e paditësit për interpretim për ATK i datës 25.02.0009, Përgjigje e ATK e datës 25.05.2010, Raporti i ekzaminimit të BQK datë 29.04.2009, Raporti vjetor i paditësit për vitin 2006-2007, Ekspertiza financiare e datës 25.03.2009 dhe plotësime të datave 30.08.2021 dhe 28.02.2020, Komunikimi elektronik i datës 19.03.2014, Deklarate e paditësit për TAK për vitin 2008, Aktgjykimi AA nr. 746/2019, Vendimet e Ministrisë së Financave për normën e interesit vjetor të datës: 23.01.2017, 20.01.2017, 20.01.2015, 03.02.2016, Shkresa e Ministrisë së Financave e datës 23.02.2016, Procesverbal i departamentit për çështje administrative e datës 26.04.2022; i datës 07.07.2021; 17.08.2021; 16.09.2021, Certifikatë e regjistrimit të biznesit nga ARBK e datës 28.12.2009.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën

Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga kërkesa për interpretim të paraqitur nga paditësi më dt. 25.02.2009 drejtuar të paditurës - Sektorit të Edukimit të Tatimpaguesve, gjykata konstaton se paditësi ka njoftuar të paditurën se ka nënshkruar kontrata për instrumente financiare të njohura si “Interest Rate Swaps”. Këto instrumente synojnë të minimizojnë rrezikun nga ndryshimet në normat e interesit në treg. Paditësi ka pyetur nëse, për qëllime tatimore të fitimit, pranohet humbja apo fitimi si pasojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre instrumenteve financiare.

Nga përgjigja me shkrim e datës 25.05.2010 nga e paditura-Divizioni për Edukim dhe Ndihmë të tatimpaguesve për paditësin, gjykata e ka konstatuar faktin se e paditura përmes kësaj përgjigje e ka njoftuar paditësin se ligji ekzistues i tatimit në të ardhura në korporata Ligji nr.03/L-162, sikurse edhe paraardhësi i tij, nuk përmban rregulla të veçanta për përcaktimin e trajtimit tatimor të instrumenteve derivative financiare, çdo do të thotë se duhet të zbatohen parimet themelore të përcaktimit të të ardhurave për biznesin. Në përgjigje është theksuar efekti i rrjedhës së parasë i normës së interesit të ndërkëmbimeve valutore pasqyron rezultatin e realizuar aktualisht të transaksioneve të instrumenteve financiare në çdo periudhë tatimore. Nëse këto transaksione rezultojnë në fitim, ky fitim duhet të përfshihet në të ardhurat e tatueshme dhe nëse rezultojnë në humbje, kjo humbje do të jetë shpenzim i zbritshëm. Trajtimi tatimor përputhet me trajtimin e kontabiliteti financiar në pasqyrën e të ardhurave. Po ashtu në përgjigje është shtuar se efekti i vlerës së drejt i normës së interesit të ndërkëmbimit valutator reflekton fitimin/humbjen e pa realizuar që del nga instrumenti financiar sikurse është vlerësuar në fund të çdo periudhe tatimore, të cilat sikurse keni vënë në dukje, reflektohen edhe në pasqyrën e të ardhurave për qëllime të kontabilitetit financiar.

Nga Raporti i Kontrollit i ATK-së-Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj i datës 18.06.2010, gjykata e ka konstatuar faktin se e paditura mbi bazën e analizës së riskut ka kryer kontroll (vlerësim tatimor) për paditësin, për periudhat dhe llojet e tatimeve; Tatim të Paragjykuar (TP) për periudhën TM4/2001-TM1/2002, Tatim Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për periudhën 01/2003-12/2008, Tatim në Fitim (TF) për periudhën 2002-2004, Tatim në të Ardhura në Korporata (TAK) për periudhën

2005-2008, Tatim në Interes, Dividendë, rentë për periudhën 01/2005-12/2008, Tatim të Mbajtur në Burim (TMB) për periudhën 04/2002-12/2008 si dhe për Kontribute pensionale (KP) për periudhën 08/2003-12/2008. Me raport të kontrollit janë konstatuar ndryshime, respektivisht ka pasur rritje të shpenzimeve që rezultojnë me rritje të humbjes, përkatësisht zvogëlim të obligimit tatimor në Tatim të Paragjykuar, zvogëlim të shpenzimeve që ka rezultuar me tatim shtesë në TAK, tatim shtesë në tatimin e mbajtur në burim për interes, tatim shtesë në TVSH dhe Tatim të Mbajtur në Burim për paga. Deri tek këto ndryshim kryesisht kishte ardhur pasi kontrolli shpenzimet e këmbimit ndërvalutor të paditësit në vlerë prej 4,958.028.00€, të deklaruara fillimisht si shpenzime të pazbritshme nga paditësi në deklaratën fillestare për TAK për vitin 2008, e cila është dorëzuar në ATK me datë 31.03.2009 nga paditësi, e më pastaj kjo deklaratë është korigjuar po nga paditësi, përmes korigjimit të dorëzuar në ATK me datë 17.08.2009, ku janë përfshirë edhe shpenzimet e këmbimit ndërvalutor në vlerë prej 4,958.028.00€, nuk i ka njohur paditësit sipas vlerës së korigjuar shpenzimet e këmbimit ndërvalutor.

Nga aktvendimi me nr.A.nr.186/2010-ATK i datës 18.09.2013, i Bordit për Rishqyrtime, konstatohet se ky institucion duke vepruar sipas ankesës së këtu paditësit të datës 14.10.2010, të ushtruar kundër vendimit të Departamentit të Ankesave të ATK-së me nr.276/2010 i datës 01.10.2010, ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, ka anuluar vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së me nr.276/2010 të datës 01.10.2010 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Në ri procedurë e paditura ishte udhëzuar që të konstatoj saktë vlerën e këmbimeve ndërvalutore të dokumentuar dhe të konfirmuar edhe nga Rregullatori i Sistemit Bankar-BQK dhe më pastaj duhet njohur si shpenzim i zbritshëm për TAK për vitin 2008, me arsyetimin se nuk mund të qëndrojnë standarde të dyfishta në kuptimin se humbjet e këmbimit ndërvalutor të njihen si shpenzim i zbritshëm pas datës së dhënies së interpretimit, kurse ato nuk mund të njihen para kësaj date, sepse në aspektin e kontabilitetit financiar nuk ka ndryshuar asgjë nga parimet themelore të të ardhurave për biznesin, por ato janë të njëjta si para apo pas datës së dhënies së interpretimit.

Nga Raporti i kontrollit i ATK-së-Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj i datës 06.08.2014, konstatohet se pas aktvendimit të BPR-së me nr.A.nr.186/2010-ATK të datës 18.09.2013, ka kryer ri kontroll për paditësin duke u thirre pikërisht në këtë vendim, ku objekt i kontrollës kanë qenë periudhat tatimore të njëjta si në Raportin e Kontrollit të datës 18.06.2010. Me

Raportin e Ri kontrollit tek rezultat e ri kontrollit është theksuar se rezultat e kontrollit mbasin sipas vlerësimit të Raportit të Kontrollit paraprak të datës 26.05.2010, dhe se nuk ka ndryshime në rezultate si dhe vlerësimit të AU011 të TAK -2008 të datës 26.05.2010. Në raport të ri kontrollit është dhënë konstatimi se në deklaratën vjetore të TAK 2008, me deklaratën e rregullt të deklaruar me datë 31.03.2009, biznesi ka paraqitur si shpenzim në vlerë prej 4,958.028.00€, në kolonën 26 shpenzimet tjera (tabela m), duke i paraqitur si të pa zbritshme, e po ashtu edhe në deklaratën TAK-2008 korigjuese të bërë me datë 17.08.2009, po ashtu në kolonën 26 te shpenzimet tjera (tabela m). Ri kontrollit nuk i ka njohur paditësit shpenzimet e këmbimit ndërvalutor si shpenzime të zbritshme sipas deklaratës korigjuese të dorëzuar nga paditësi me datë 17.08.2009, te rubrika 20 fonde rezervë, në shumën prej 6,104.716.13€, nga vlera prej 1,805,496.94€ të deklaruara në deklaratën fillestare në vlerën prej 7,910,213.07€, në deklaratën korigjuese, me arsyetimin se nuk janë dokumentuar sipas Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Rregulloren nr.2004/51 mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave, e po ashtu sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhura të Korporatave nr.03/L-162, neni 9, paragrafi 7.

Nga vendimi i kontestuar me nr.446/2014 i datës 18.12.2014 i Departamentit të Ankesave të ATK-së, konstatohet se e paditura e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr.446/2014 të datës 30.10.2014, të paditësit dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë për Tatimin në të Ardhura të Korporatave për vitin 2008 i ka vërtetuar si të bazuara. Në arsyetim të vendimit të kontestuar e paditura ka theksuar se sa i përket kontestit të tatimpaguesit për mos pranimin e shpenzimeve të këmbimeve ndërvalutore për Tatimin në të Ardhura të Korporatave për vitin 2008 në vlerë prej 4,958,028.00€, bazuar në analizën e dosjes së tatimpaguesi vërteton se ri kontrollit ka vlerësuar me të drejt, bazuar në Ligjin nr.2004/48 dhe Rregulloren me nr.2004/51, neni 7, si dhe UA nr.01/2005 për Zbatimin e Rregullores me nr.2044/51 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, neni 3. E paditura në vendimin e kontestuar ka shtuar se gjatë analizimit të dosjes, bazuar në shkresën e BQK-së, lidhur me informatat përkatëse të “SWAP” kontratave të “Raiffiesen Bank Kosovo”, sipas së cilës shkresë BQK-ja ka informuar RBKO se nuk ka përgatitur strategji për hyrjen në marrëveshje kontraktuale të instrumenteve financiare “SWAP” të përcaktuara me anë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, përkatësisht SNK 39 dhe duke mos poseduar asnjë konfirmim, nga ana e BQK-së për këto shpenzime, konstaton se të njëjtat nuk di të pranohen si shpenzime të zbritshme për Tatimin në të Ardhura të Korporatave për vitin 2008.

Nga vlerësimet e nxjerra të ekspertit financiar të dhëna në ekspertizën financiare të datës 23.05.2019, eksperti financiar ka dhënë konstatimet se pala paditëse “Raiffeisen Bank Kosovo” JSC ka pasur të drejtë në pretendimin se vlera e këmbimeve ndër valutore (SWAP transaksioneve), për vitin 2008, në shumë të përgjithshme prej 4,958,028.00€ është dashur të trajtohet si shpenzim i zbritshëm gjatë kontrollit tatimor të kryer nga e paditura ATK. Si rrjedhim i mos trajtimit të shpenzimeve të përmendura më lartë, ATK gjatë kontrollit tatimor palës paditëse për vitin 2008 i ka llogaritur një vlerë të tatimit prej 991,605.60€, më shumë. Pas ekzaminimit të dhënave dhe konsultimit me dispozita ligjore relevante të pasqyruara në ekspertizë, eksperti ka konstatuar se as në nenin 7 (shpenzime e lejueshme) e as në nenin 8 (shpenzimet e palejueshme) të Rregullores nr.2004/51 mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave, nuk ka përkufizime se këmbimet ndërvalutore (SWAP transaksionet) nuk mund të pranohen si shpenzime të zbritshme. Rrjedhimisht, kjo rregullore e favorizon palën paditëse në këtë kontest gjyqësore. Eksperti po ashtu në ekspertizë ka konstatuar se ATK gjatë kontrollit të paditësit për vitin 2006 ka njohur/pranuar këmbimet ndërvalutore (SWAP transaksionet) si shpenzime në vlerë prej 30,400.00€, ndërsa në vitin 2007 ka njohur si të ardhura në pasqyrat financiare vlerën prej 42,619.00€, nga këmbimet ndërvalutore, andaj nuk mund të zbatohen standarde të dyfishta për të njëjtin lloj të shpenzimit varësisht nga viti i kontrollit, sidomos ku kihet parasysh se të gjitha vitet 2006, 2007, 2008, i janë nënshtruar kornizës së njëjtë legislative. Tutje eksperti financiar duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës, ka dorëzuar me datë 30.08.2021 plotësimin e ekspertizës financiare të datës 23.05.2019, ku në këtë plotësim ka dhënë konstatimin se me Ligjin nr.03/L-222 është parashikuar përlllogaritja e kamatës për rimbursimet e vonuara, gjegjësisht tatimet e ri paguara që ATK, duhet t’ua kthej tatimpaguesve në rast se ata i fitojnë lëndës në procedurë ankimore. Kjo gjë është parashikuar në nenin 28, par.4 dhe nenin 30 par.5 të Ligjit nr.03/L-222. Sipas plotësimit të ekspertizë financiare vlera e kamatës së përlllogaritur të obligimeve të paditurës ndaj paditësit sipas detyrës së dhënë me aktvendimin për plotësim të ekspertizës të datës 07.07.2021 është 202,648.34€, ndërsa është konstatuar se e paditura i ka falur paditësit vlerën prej 54,528.09€, për vitin tatimor 2008 për TAK, sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike.

Nga procesverbali i datës 16.09.2021, gjykata Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, konstatohet se gjykata përsëri e ka kthyer në

plotësim ekspertizën financiare, përkatësisht plotësimin e saj të datës 30.08.2021, duke e obliguar ekspertin financiar edhe një herë ti analizoj shkresat e lëndës, të kërkoj sqarimet e nevojshme nga palët ndërgjyqëse nëse e sheh të nevojshme dhe pas kësaj të bëjë plotësimin e ekspertizës financiare, me detyrat që të nxirret konstatimi se sa ka qenë tatimi i përlloritur për paditësit për vitin 2008 për TAK sipas vet deklarimit të paditësit, të nxjerr konstatimin nëse deklarata për TAK për vitin 2008 është korrigjuar më vonë nga paditësi, nëse po në cilat zëra të saj është korrigjuar dhe sa ka qenë detyrimi tatimor i përlloritur për TAK pas korrigjimit, pastaj të nxjerr konstatimin se kur është paguar detyrimi tatimor për TAK 2008 nga paditësi dhe në çfarë shume, si dhe të nxjerr konstatimin se sa ka qenë obligimi i paditësit për TAK për vitin 2008 sipas Raportit të ri kontrollit të ATK-së në vitin 2014.

Në ri gjykim gjykata/Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës të dhëna me aktvendimin AA.nr.746/2019 të datës 19.03.2021, në seancën gjyqësore të datës 07.07.2021, e ka kthyer në plotësim ekspertizën financiare të ekspertit Afrim Konjufca të datë 23.05.2019, duke e obliguar ekspertin që të nxjerr konstatimin nëse me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 është paraparë kamat vonesa-interesin të cilin ATK duhet tu kthej-paguaj tatimpaguesve, në rast se ata i fitojnë lëndët në procedurë ankimore, nëse po sa është kjo kamatë dhe mbi këtë bazë të llogarit edhe kamatën për paditësin nga data kur paditësi ka ushtruar ankesë në DA me datë 21.06.2010 e deri në datën e nxjerrjes së plotësimin të ekspertizës financiare, si dhe të nxjerr konstatimin nëse paditësit i është falur ndonjë obligim tatimor nga ana e të paditurës, bazuar në Ligjin për Faljen e Borxheve Publike i cili ka qenë në fuqi, për periudhën 2008 për TAK.

Eksperti financiar me datë 28.02.2022 gjykatës i ka dorëzuar plotësimin e dytë të ekspertizës financiare të datës 23.05.2019. Në këtë plotësim si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.04.2022 eksperti ka dhënë konstatimin se vlera e deklaruar e tatimit për TAK nga paditësi për vitin 2018 sipas deklaratës fillestare për TAK të datës 31.03.2009 ka qenë 5,035.054,73€, ndërsa sipas deklaratës korrigjuese për TAK të datës 17.08.2009 ka qenë 3,814.111,50€. Eksperti ka dhënë konstatimin se koha kur janë paguar dhe vlera e paguara për TAK nga paditësi kanë qenë; 15.04.2008 Tremujori i parë-TM1 vlera prej 910,000.00€, 15.07.2008 Tremujori i dytë-TM2 vlera prej 910,000.00€, 15.10.2008 Tremujori i Tretë-TM3 vlera prej 910,000.00€, 15.01.2009 Tremujori

i katërt-TM4 vlera prej 910,000.00€, si dhe pagesa finale për vitin 2008 me datë 31.03.2009 vlera prej 1,395,054.73€. Sipas plotësimit të dytë të ekspertizës financiare vlera e TAK-ut sipas raportit të ri kontrollit të datës 06.08.2014 për paditësin është vlera prej 3,747,803.19€. Në seancën e datës 26.04.2022 eksperti ka deklaruar se siç e ka paraqitur në faqen 8 të plotësimit të parë të ekspertizës, konstatimin për faljen e borxhit për TAK të palës së paditur për paditësin e ka nxjerr nga raporti i gjendjes së ATK-së dhe siç është paraqitur në faqen 8 borxhi është falur me datën 03.11.2015 dhe i përket periudhës 2008, kjo bazuar në Ligjin për Faljen e Borxheve Publike i cili ka ardhur në fuqi në periudhën pas vitit 2008. Sipas ekspertit tatimpaguesi më vonë ka bërë deklaratë korrigjuese në të cilën i ka përfshirë në shpenzime edhe transkasionet “SWAP” në bazë të përgjigjes të cilën e kanë marr nga ATK, gjegjësisht Divizioni për Edukim dhe Ndhimë të Tatimpaguesve. Eksperti ka konstatuar po ashtu se nëse nga vlera e konstatuar prej 991,605.60€, zbritet vlera e falur sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike në shumë prej 54,528.09€, mbetet vlera prej 937,077.51€.

Sipas procesverbalit, konstatohet se gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 26.04.2022 në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar inspektori tatimor i të paditurës D.K. i cili ka kryer ri kontrollin për paditësin me Raportin e Ri Kontrollit të datës 06.08.2014, sipas propozimit të autorizuarës së palës së paditur të bërë në seancën e datë 16.09.2021, ku gjykata kishte aprovuar edhe propozimin për dëgjimin edhe të dëshmitarit tjetër Fatos Mexhuani, mirëpo në seancën e shqyrtimit kryesor e autorizuarës e të paditurës ishte tërhequr nga propozimi që të dëgjohet edhe ky zyrtar i të paditurës në cilësi të dëshmitarit, me arsyetimin se i njëjti ka qenë vetëm inspektor mbështetës i kontrollit dhe se rolin kryesor gjatë kontrollit e ka pasur inspektori tatimor.

Dëshmitari D.K. kishte deklaruar se paditësi fillimisht ka qenë në procedurë të kontrollit të rregullt në vitin 2010, për periudhën 2005-2008. Në momentin kur paditësi e ka deklaruar deklaratën vjetore në TAK për vitin 2008 deri me datë 31.03.2009, i ka deklaruar si të pa zbritshme shpenzimet e këmbimeve ndërvalutore të quajtura si “SWAP” kontrata. Ka theksuar se me datë 25.02.2009 pala paditëse i është drejtuar ATK-së rreth këtyre shpenzimeve ndërvalutore dhe ATK në atë kohë nuk i ka kthyer përgjigje lidhur me këtë kërkesë. Me datë 17.08.2009 paditësi ka bërë korrigjim të kësaj deklarate të TAK për vitin 2008 dhe sipas kësaj deklarate të korrigjuar paditësi ka dal në kreditim për vlerën e përmendur në deklaratë. Sipas dëshmitari arsyeja pse ri kontrolli nuk i ka njohur shpenzimet ndër valutore paditësit ka qenë se këtu paditësi me “Raiffaisenin” në Austri kanë qenë

persona të lidhur sepse paditësi është njësi e qendrës në Austri dhe kjo dëshkohet edhe me kontratat të cilat kanë qenë të lidhura e të cilat i ka trajtuar kontrolli. Dëshmitari po ashtu ka deklaruar se kemi kërkuar dëshmi nga paditësi për këto shpenzime nëse këto shpenzime nga ana e qendrës kanë ndodhur dhe nëse këto shpenzime janë shpërnda nga ana e qendrës edhe për njësi tjera në rajon, por që nuk kemi përgjigje lidhur me këto informata dhe se arsyeja tjerët për mos njohjen e këtyre shpenzimeve lidhet me atë se vet pala fillimisht i kishte deklaruar si të pa zbritshme. Dëshmitari në pyetjen e gjykatës se me raportin e kontrollit të parë, po edhe të ri kontrollit a i ka njohur e paditura paditësit fitimin e realizuar si rezultat i këmbimeve ndërvalutore dhe a i ka njohur shpenzimet e këmbimeve ndër valutore për vitin 2006 dhe 2007, ka deklaruar se ATK i ka njohur për vitin 2006, 2007 dhe 2008 fitimin dhe shpenzimet e këmbimeve ndërvalutore siç i ka deklaruar pala në deklarata të rregullta vjetore.

Duke vepruar sipas ankesës të së paditurës, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1452/22 të datës 20.07.2023, ka anuluar aktgjykimin A.nr.93-15, të datës 26.04.2022 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje dhomave të shkallës së parë- Departamenti Fiskal, të kësaj gjykate. Dhomat e shkallës së dytë kanë dhënë vërejtje se gjendja faktike nga dokumentacioni i lëndës është dashur të vërtetohet mbi bazën ligjore të cilën e ka zbatuar e paditura Ligji nr.2004/48 dhe Rregullorja 2004/51, Udhëzimi Administrativ nr.01/2005 për zbatimin e Rregullores 2004/51 për Tatimin në të ardhurat e Korporatave, ku si bazë referuese është dashur të merret edhe përgjigja me shkrim e dhënë nga Banka Qendrore e Kosovës, sa i përket vlerësimeve të instrumenteve financiare SWAP, pastaj dokumentimi i shpenzimeve swap të kontratave, ku e paditura ka mohuar të jep përgjigje kontrollit sa i përket ndodhjes së shpenzimeve me degën amë në Austri.

Rregullorja 2004/51 shpenzimet i ka rregulluar me kapitullin III, ku në nenin 7 janë përcaktuar Shpenzimet e lejueshme si në vijim “7.1 Në varësi të kufizimeve të kësaj Rregulloreje, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periodës tatimore në terësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike. 7.2 Nuk lejohet zbritje për kurrfarë shpenzimesh përveç nëse dokumentohet sipas mënyrës së paraparë me udhëzimin administrativ që do ta nxjerrë Ministria për Ekonomi dhe Financa.”, ndërsa me nenin 8 janë rregulluar Shpenzimet e palejueshme, ashtu që është

përcaktuar se “Gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme shpenzimet e mëposhtme janë të palejueshme: (a) Shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës; (b) Shpenzimet e përvetësimit, përmirësimit, ripërtëritjes dhe rindërtimit të mjeteve të cilat janë zhvlerësuar ose amortizuar në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje; (c) Gjobat dhe denimet; (d) Tatimi në të ardhura dhe (e) Tatimi në vlerën e shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kredi për tatimin në repromaterial në bazë të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/11 të datës 31 maj 2001 për tatimin në vlerën e shtuar.” Ndërsa në nenin 3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2005, Mbi Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/51 Mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave është paraparë që “Në përputhje me Nenin 7 të Rregullores, tatimpaguesit i lejohet të zbresë nga të ardhurat bruto shpenzimet e paguara ose të kryera gjatë periudhës tatimore gjatë veprimtarive ekonomike. Për të lejuar si zbritje, të gjitha shpenzimet duhet të jenë në tërësi të dokumentuara dhe dokumentacioni mbështetës sikurse janë kontratat, faturat, deklarat e doganës, kuponat, dokumentet e pagesës, dokumentet bankare, regjistrimet e listës së pagave, biletat, dëftesat, urdhër transferet dhe dokumente tjera përkatëse duhet të jenë të gatshme për inspektim me kërkesën e Administratës Tatimore”.

E paditura, respektivisht Divizioni për Edukim dhe Ndhimë të Tatimpaguesve në përgjigjen e dhënë me datë 25.05.2010 në kërkesën e paditësit për interpretim nëse për qëllime të tatimit në fitimit a pranohet humbja gjegjësisht fitimi që është si rezultat i vlerës së tregut të instrumentit financiar, e paditura ka dhënë përgjigjen se ligji ekzistues i tatimit në të Ardhurat në Korporatat ligji 03/L-162 sikurse edhe paraardhësi i tij, nuk përmban rregulla të veçanta për përcaktimin e trajtimit tatimor të instrumenteve derivative financiare, që do të thotë duhet të zbatohen parimet themelore të përcaktimit të të ardhurave për biznesin. Në përgjigje është theksuar efekti i rrjedhës së parasë i normës së interesit të ndërkëmbimeve valutore pasqyron rezultatin e realizuar aktualisht të transaksioneve të instrumenteve financiare në çdo periudhë tatimore. Nëse këto transaksione rezultojnë në fitim, ky fitim duhet të përfshihet në të ardhurat e tatueshme dhe nëse rezultojnë në humbje, kjo humbje do të jetë shpenzim i zbritshëm.

Gjykata nga shkresat e lëndës konstaton se e paditura kishte pranuar shpenzimet e këmbimeve ndërvalutore të deklaruar nga paditësi për vitin 2006, mirëpo për periudhën 2008 nuk i ka pranuar shpenzimet e këmbimit ndërvalutor në vlerën e deklaruar/korigjiuar nga paditësi.

Veprimi i tillë konsiderohet aplikim i statndardeve të dyfishta nga e paditura, gjithashtu duke marr për bazë se në vitin 2007 e paditura i ka njohur paditësit të ardhura në pasqyrën financiare vlerën e realizuar nga këmbimet ndërvalutore e që konfirmohet nga leximi i procesverbaleve të seancës gjyqësore të mbajtura në Divizionin Fiskal të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, respektivisht dëgjimit të dëshmitarit Demë Korça.

Lidhur me vërejtjen e Dhomave të Shkallës së dytë që gjendja faktike duhet të vërtetohet mbi bazën ligjore të zbatuar nga e paditura ku si bazë referuese është dashur të merret përgjigja me shkrim e dhënë nga Banka Qendrore e Kosovës, Gjykata vlerëson se çështja e njohjes së shpenzimeve të lejueshme për qëllime tatimore është çështje e cila hyn në fushëveprimin e legjislacionit tatimor dhe se paditësi ka ofruar mjaftueshëm prova e të cilat janë në harmoni me dispozitat ligjore të cilat ishin në fuqi dhe atë nenin 7 të Rregullores nr.2004/51 mbi tatimin në të Ardhura të Korporatave dhe neni 3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2005, mbi zbatimin e Rregullores nr.2004/51 mbi tatimin në të ardhura të korporatave të cilat parashohin se për njohjen e shpenzimeve të biznesit është paraparë që të ardhurat bruto të paguara të lidhen me veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit dhe të dokumentohen me dokumentacion përkatës siç janë kontratat, faturat, dokumentet e pagesës etj. Ndërsa arsyetimi i të paditurës se vendimi i kontestuar është bazuar në shkresën e BQK-së e cila ka informuar se paditësja nuk ka përgatitur strategji për hyrjen në marrëveshje kontraktuale të instrumenteve financiare “SWAP” të përcaktuara me anë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, gjykata vlerëson se konstatimi i tillë është i pabazuar meqë Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili ligj nuk parasheh se është detyrë e BQK për të përcaktuar dokumentet qe institucionet financiare duhet ti paraqesin për tu njohur shpenzimet e biznesit për qëllime tatimor, por është legjislacioni tatimor që e rregullon një gjë të tillë. Në rastin konkret janë pikërisht dispozitat e lartcekura ligjore të cilat edhe është dashur ti zbaton e paditura kur ka vendosur lidhur me ankesën e këtu paditësit.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, vlerësimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e vendimit kontestues, gjykata duke vepruar edhe në përputhje me dispozitat e nenit 46 par.5 të LKA-së ku shprehimisht thuhet “*Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë*

të sigurt”, erdhi në përfundim se pretendimet e paditësit janë të bazuara, të drejta dhe të ligjshme, andaj e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e Administratës Tatimore të Kosovës nr.446/2014 të datës 18.12.2014, si dhe e obligoj të paditurën që paditësit t’ia kthejë shumën prej shumën prej 937,077.51€, të paguar nga paditësi, si rezultat i mos njohjes së shpenzimeve të këmbimeve ndërvalutore (swap transaksioneve), si shpenzime të zbritshme në pasqyrën e të ardhurave për vitin 2008, për Tatim në të Ardhura të Korporatave. Gjykata këtë shumë e bazoi në të gjeturat e ekspertizës financiare të datës 23.05.2019 dhe të plotësuar me datë 30.08.2021, dhe në nga procesverbali i shqyrtimit kryesor, ku është konstatuar se ATK me datë 03.11.2015, paditësit i ka falur vlerën prej 54,528.09€, për vitin tatimor 2008, për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike me nr.05/L-043, i cili ligj ka hyrë në fuqi në muajin shtator 2015 dhe ka qenë në fuqi deri me 1 shtator 2017, sipas Ligjit nr.05/L-119 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë në vlerën prej 54,528.09€, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që paditësi nuk ka të drejt të kërkojë kthimin e kësaj shume e cila në bazë të gjendjes së tatimpaguesit në ATK të përfshirë në plotësimin e ekspertizës financiare të datës 30.08.2021, rezulton se të njëjtit i është falur me datë 03.11.2015, konstatim të cilin e ka mbrojtur eksperti financiar edhe në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në rigjykim.

Gjykata përkundër deklarimeve të dëshmitari se me ri kontroll paditësi nuk është ngarkuar me tatim shtesë por ka mbete rezultati i kontrollit të parë sepse kontrolli i parë e kishte kthyer gjendjen sipas deklarimit fillestar të tatimpaguesit para datës 31.03.2009, konstatoj një gjendje tjetër faktike sa i përket tatimit shtesë me të cilin është ngarkuar paditësi me ri kontroll, pasi që siç ka konstatuar edhe eksperti financiar në ekspertizë bazë të datës 23.05.2019 në faqe 15, në rubrikën 42 të tabelës paditësi me ri kontroll është obliguar me tatim shtesë në vlerë prej 105,339.86€ dhe ky fakt u vërtetua edhe nga Njoftim Rivlerësimi i përpiluar pas ri kontrollit i datës 16.04.2019 për paditësin, nga ku shihet në rubrikën 42 tatimi për pagesë në këtë formular 105,339.86€. Nga kjo rezulton që paditësi me ri kontroll është ngarkuar me tatim shtesë në TAK për vitin 2008, për vlerën prej 105,339.86€, prej të cilës vlerë më pastaj i është falur shuma prej 54,528.09€, me datë 03.11.2015, sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike i cili ka qenë në fuqi.

Në lidhje me kamatën gjykata ka vendosur konform nenit 57.4 të Ligjit nr.2044/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është parashikuar se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”* dhe dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*.

Vendimi për shpenzimet e procedurës si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata e mori në pajtim me nenin 64 të LKA-së.

Nga të lartcekura, gjykata konform nenit 46 par.2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.606/23, datë 21.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.